

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Ministarstvo Privrede i Finansija - Ministry of Economy and Finance

Administrata Tatimore e Kosoves - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 14 / 2010
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-162 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT
E KORPORATAVE

Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Mbështetur në nenin 39 të Ligjit Nr. 03/L-162, "Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave,"
Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave,

nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV

Nr. 14/ 2010

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-162, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është vendosja e procedurave dhe kërkesave për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr 03/L-162, "*Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave*", (në vijim Ligji).

Neni 2 Të Ardhurat nga Shitja e Mallrave

1. Tatimpaguesit me të ardhura nga shitja e mallrave, të cilët mbajnë stokun, për të përcaktuar koston e mallit të shitur, duhet të përdorin metodën FIFO (i pari-brenda –i pari-jashtë) ose metoda të tjera të tilla të lejuara sipas Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës (p.sh kostoja mesatare e ponderuar ose metoda specifike të identifikimit), me kusht që tatimpaguesit mos të ndryshojnë metodën e tyre të stokut gjatë një periudhe tatimore.

(Koment: Standardet Kosovare të Kontabilitetit po shkojnë drejt bazimit të tyre në IFRS (Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar). Meqë metoda LIFO (i fundit brenda- i pari jashtë) nuk lejohet sipas IFRS-s, në Kosovë më nuk lejohet shfrytëzimi i saj për qëllime të tatimit në të ardhura).

2. Metoda që zgjedhet për përcaktimin e koston së mallrave të shitura, shfrytëzohet për vitin në të cilin është zgjedhur, plus së paku për tri vite të tjera tatimore shtesë. Tatimpaguesi i cili ka aspirata të ndryshojë këtë metodë, pas asaj periudhe kohore, kërkon një shpjegim individual nga Administrata Tatimore e Kosovës (në vijim ATK) që të autorizoj këtë ndryshim në përpjuthshmëri me dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimit Administrativ të nxjerr për këtë Ligj.

Neni 3 Të Ardhurat nga Pasuritë e Paprekshme

1. Për qëllime të paragrafit 1.10 të nenit 2 të Ligjit, kategoritë e pasurive të pa prekshme të cilat përbëhen vetëm nga të drejtat që nuk kanë formë fizike janë:

1.1. patentat, shpikjet, formulat, proceset, dizajnet, modelet, sekretet e tregëtisë dhe ofrimi i njohurive të veqanta;

- 1.2. të drejtat e autorit duke përfshirë të drejtat për veprat letrare, kompozimet muzikore ose artistike;
- 1.3. shenjat tregëtare, emrat tregëtar ose emrat e markës;
- 1.4. të drejtat ekskluzive, licencat ose kontratat;
- 1.5. metodat, programet, sistemet, procedurat, fushatat, anketat, studimet, parashikimet, vlerësimet, listat e klientëve, ose të dhënat teknike
- 1.6. softuerat kompjuterik; dhe
- 1.7. të drejtat e tjera të ngjashme

2. Në lidhje me softuerët kompjuterik, licencat (si dallim nga shitjet) e të drejtave të autorit në programin kompjuterik, dhënia e të drejtës për përdorim (si dallim nga shitjet) e kopjeve të programeve që i nënshtrohen të drejtave të autorit, dhe furnizimet e njohurive për programet kompjuterike (si dallim nga furnizimet e shërbimeve për zhvillimin ose modifikimin e programeve kompjuterike) do të konsiderohet si e ardhur nga pasuritë e pa prekshme në formë të të drejtave pronësore.

Neni 4 **Të Ardhurat nga Ndërtimi Afatgjatë**

1. Paragrafi 5 i nenit 5 të Ligjit, parasheh shmangien nga rregullat normale të përcaktimit të të ardhurave të tatueshme për tatimpaguesit e angazhuar në projektet dhe kontratat afat gjate ndërtimore. Për qëllim të këtij neni, kontratat ndërtimore afat gjate dhe projektet janë kontratat dhe projektet që lidhen me punën ndërtimore ku ndërtimi shtrihet më gjatë se një vit i të ardhurave. Këto kontrata përfshijnë ato për:

- 1.1. ndërtimin e ndërtesave, urave, pendave, shtrirjes së gypave, tuneleve dhe projektet tjera të inxhinieringut civil,
- 1.2. aktivitetet që lidhen me këto si demolimi, gërryerja, projektet e largimit të madh të dheut,
- 1.3. ndërtimi i gjërave të mëdha të fabrikave duke përfshirë anjjet dhe vaporat transportues, dhe
- 1.4. kontratat e ngjashme në fushat e lidhura p.sh kontratat për klima dhe nxemje kontratat e mëdha të vënies së rrjetës elektrike dhe rivënjes së rrjetës elektrike, renovimet e mëdha të hoteleve, shitoreve etj, kontratat e mëdha të menagjimit të ndërtimit etj.
- 1.5. Mirëpo këtu nuk përfshihen kontratat e shitjes dhe furnizimit gjatë kohës kur këto zakonisht mund të konsiderohen si shitje e stokut tregëtar p.sh nuk përfshijn instalimin e mobiljeve të zyrës në ndërtesën e re edhe në ato raste kur mobiljet duhet të instalohen gjatë dorëzimit.

2. Për qëllime të tatimit në të ardhurat e korporatave, tatimpaguesit e angazhuar në kontratat dhe projektet afat gjate ndërtimore kategorizohen në tri kategori të mëdha si në vijim:

- 2.1. “punëkryes” – ata që e kryejn punën ndërtimore (qoftë në mënyrë direkte ose nëpërmes të nën kontraktorëve) –ata në përgjithësi paguhen nga një “investitor” i cili paguan në mënyrë progresive për punën ndërtimore, nëpërmes të një kombinimi të pagesave të avancit, pagesave progresive dhe pagesave finale;
- 2.2. “investitorët” – ata që financojnë punën e kontratës ndërtimore dhe që paguajn “punëkryesin” për atë punë.
- 2.3. “punëkryes-investitor” ata që edhe e financojnë edhe e kryejnë punën e kontratës ndërtimore vetë.

3. Për qëllime të Tatimit në të Ardhurat në Korporata:

3.1. “punëkryesit” lejohen të shfrytëzojnë metodën e “përçindjes së kryerjes së parashikimeve të shpenzimeve” (ku të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara bazohen në proporcionin e ndërtimit që është kryer bazohet në proporcionin që kanë shpenzimet e krijuara të kontratës për punën deri në atë datë, në krahasim me shpenzimet totale të parashikuara të kontratës.

Shembull:

Shembulli në vijim ilustron një metodë të përcaktimit të fazës së kompletimit të një kontrate dhe kohëzgjatjen e njohjes së të hyrave dhe shpenzimeve të kontratës.

Një kontrator ndërtimor e ka një çmim fiks prej 250,000 euro që të ndërtoj një urë. Shuma fillestare e të hyrave të pajtuara në kontratë është 250,000 euro. Supozimi fillestar i kontraktorit për shpenzimet e kontratës është 150,000 euro. Ndërtimi i objektit do të ndodh gjatë vitit 2010 dhe 2011.

Kontraktori e përcakton fazën e kompletimit të kontratës duke e llogaritur pjesën që shpenzimet e kontratës kanë dalë për punën e kryer deri më tani duke pasur mbajtur shpenzimet totale më të fundit të kontratës. Një përmbledhje e të dhënave financiare gjatë periudhës së ndërtimit është me sa vijon:

| | 2010 | 2011 | |
|--|---------|---------|------|
| Shuma fillestare e të hyrave e pajtuar në kontratë | 250,000 | 250,000 | |
| Shpenzimet e ndodhura deri me date | 90,000 | 150,000 | |
| Shpenzimet e kontratës për kompletimin e punës | 60,000 | | |
| Shpenzimet totale të vlerësuara të kontratës | 150,000 | 150,000 | |
| Fitimi i vlerësuar | 100,000 | 100,000 | |
| Faza e kompletimit (90,000/150,000) | | 60% | 100% |

Shumat e të hyrave, shpenzimeve dhe fitimit të njohur në pasqyrën e të ardhurave në dy vitet me sa vijon:

| Deri më tash | Të njohura në vitin e kaluar | Të njohura në vitin aktual 2010 | |
|----------------------------|------------------------------|---------------------------------|---------|
| 2010 | | | |
| Të hyrat (250,000 x 60%) | 150,000 | 150,000 | |
| Shpenzimet (150,000 x 60%) | 90,000 | | 90,000 |
| Fitimi | 60,000 | 60,000 | |
| 2011 | | | |
| Të hyrat | 250,000 | 150,000 | 100,000 |
| Shpenzimet | 150,000 | 90,000 | 60,000 |
| Fitimi | 100,000 | 60,000 | 40,000 |

3.2. “investitorët” dhe “punëkryesitinvestitorët” janë të detyruar të shfrytëzojnë metodën e “tatarjes sipas përlogaritjes (ku të ardhurat raportohen duke u bazuar në pagesa, akruale (kur ka pranime dhe/ose ekziston e drejta për ti pranuar bazuar në kontratë), dhe shpenzimet lejohen proporcionalisht në baza të njëjta. Në situatat kur në asnjë periudhë tatimore nuk është pranuar

asnjë e ardhur dhe nuk është bërë asnjë kontratë të cilat do të mundësonin të drejtën për të pranuar të ardhurat, atëherë nuk ka të ardhura për tu raportuar, dhe shpenzimet nuk do të lejohen në relacion me kontratat afat gjate ndërtimore në atë vit tatimor.

Shembull:

Kontrata 2 vjeqare me të ardhurat totale të pritura të kontratës prej 200,00 euro dhe shpenzimet totale të projektit prej 150,000 euro. Fondet e pranuar në vitin e parë 100,000 euro. Shpenzimet e krijuara në vitin e parë 50,000 euro. Njohja e të ardhurave për vitin e parë do të jetë si në vijim: Të ardhurat në vitin e parë 100,000 euro (që përfaqësojnë 50% të të ardhurave totale të pritura të kontratës) 75,000 euro (që janë 50% e shpenzimeve totale të pritura).

Fitimi bruto 25,000 euro.

3.3. Kur me përfundimin e kontratës ndërtimore nga “investitorët” ose “Punëkryesit/investitorët” ekzistojnë pjesë të ndërtimit që kanë mbetur të pa shitura, ku të ardhurat nga këto shitje (dhe shpenzimet e tyre përcjellëse) nuk janë njohur ende, vlera e këtyre pjesëve të pashitura do të regjistrohet si inventar i investitorit ose punëkryesit/investitorit dhe të regjistrohen në gjendjen e tyre të bilancit deri sa të ndodhë shitja.

3.4. Nuk lejohet të shfrytëzohet metoda e “Kryerjes së kontratës” (ku nuk raportohen të ardhura ose shpenzime deri në vitin në të cilin kryhet kontrata ndërtimore afat-gjate).

3.5. Drejtori i Përgjithshëm i ATK-s në të ardhmen, mund të nxjerr një shpjegim publik, dhe lejohet metoda të tjera për regjistrimin e të hyrave dhe shpenzimeve në kontratat ndërtimore afat gjate, përveq këtyre të përmendura më lartë,

3.6. Çdo tatimpagues që ka filluar kontratat ndërtimore afat gjate para datës së hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, të cilat janë llogaritur me metodë tjetër nga këto të lejuara sipas këtij paragrafi, duhet të ndryshojnë metodën e tyre dhe shfrytëzojnë ato të lejuarat sipas këtij paragrafi, në vitin tatimor në të cilin ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi, dhe do të bëjnë një rregullim të të ardhurave të tyre të tatueshme në atë vit tatimor për të pasqyruar ndryshimin e metodës.

4. Shumë kontrata ndërtimore afatgjate dhe projekte përfshijnë ngarkimin e pagesave të kontratës së “avancit” në fillim, të cilat mund të jenë të pagueshme kur vetëm pak shpenzime kanë ndodhur ose kur nuk kanë ndodhur shpenzime. Në kësi raste taturaja e këtyre të ardhurave, duhet të përcaktohet sipas metodë që e shfrytëzon tatimpaguesi për të llogaritur të ardhurat nga këto kontrata dhe projekte. Nëse Tatimpaguesi shfrytëzon metodën e Tatimit në të ardhura kur janë përllogaritur” (investitori dhe punëkryesi/investitori), si pagesat e “avancit”, do të jenë pjesë e të ardhurave të tatueshme kur të jenë pranuar, mirëpo nëse tatimpaguesi shfrytëzon metodën “e përqindjes së ndodhjes së shpenzimeve të parashikuara “ (punëkryesit), këto pagesa të “avancit” vetëm do të jenë pjesë e të ardhurave të tatueshme vetëm në baza të shpërndarjes sipas rrjedhjes së kontratës.

5. Është me rëndësi që të pranuarat ose përqindjet e kryerjes të pasqyrohen drejt afër fundit të viti ose në fund të çdo viti tatimor. Tatimpaguesi që shfrytëzon metodën e “taturjes së të ardhurave ashtu siq përllogariten” nuk mund të shtyjë vlerësimin e të ardhurave të kontratës thjesht duke u përmbajtur në mënyrë të qëllimshme nga ose duke e shtyer faturimin deri pas fundit të vitit tatimor, kur ka qenë e drejta sipas kontratës për të faturuar para fundit të vitit tatimor.

6. Pavarësisht nga paragrafet më lartë, nëse nodnjë kontratë afat gjate ndërtimore mbanë dispozitën për pagesat e mbajtjura (ku është një dispozitë për klientët që të mbajnë përqindjen e çmimit të

kontratës deri sa të kaloj periudha në kontratë e mbajtjes të specifikuar), këto pagesa nuk do të jenë pjesë e të ardhurave të tatueshme derisa kontraktori ti pranojë ato ose të ketë të drejtën ti pranojë ato nga klienti. Kur këto para të mbajtura i paguhen kontraktorit aktualisht para se ato të jenë obligim, me kusht që kontraktorit të përmirësojë çdo defekt para se puna ndërtimore ti dorëzohet ose të pranohet nga klienti, ato do të trajtohen si të ardhura të tatueshme kur këto para të pranohen, përveç nëse mbahen në llogari të veqantë dhe nuk janë në dispozicion për pagesë apo shfrytëzim të përgjithshëm nga kontraktori, derisa të përfundohen punët ndërtimore, në q' rast parat nuk do të trajtohen si të ardhurat të tatueshme deri sa kontraktori të ketë të drejtën ti tërheq ose përdorë ato.

7. Kur ka transaksione këmbimi (barter) si pjesë e kontratave ndërtimore afat gjate, këto transaksione do të njihen si të ardhura ose shpenzime me vlerën e tregut në pajtueshmëri me nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën tatimore dhe Procedurat. Në këto situata kur vlerat e tregut nuk mund të përcaktohen ose vlerësohen në mënyrë të arsyeshme, investitori ose punëkryesi/investitori mund të aplikojnë në ATK (me evidence përkatëse të justifikueshme) për të aprovuar njohjen e këtyre të ardhurave dhe shpenzimeve nga transaksioni i këmbimit (barter) në fundë të kontratës ndërtimore.

Neni 5 **Të Ardhurat nga Lizingu**

1. Paragrafi 6 i nenit 5 të Ligjit kërkon nxjerrjen e një akti nën-ligjor për të shpjeguar se si përcaktohen dhe raportohen të ardhurat e tatueshme nga lizingu financiar dhe operativ.

2. *"Lizingu Financiar"* është përcaktuar në paragrafin 1, 27 të nenit 2 të Ligjit, si *"lizing që transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe pagesat e rastit për pronësinë e një zëri të pronës"*. Lizingu financiar duhet megjithatë të plotësojë së paku një nga këto katër kushte:

- 2.1. afati i lizingut të jetë më i gjatë se shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të jetës së përdorimit të asetit të dhënë me lizing;
- 2.2. të ketë transferim të pronësisë së asetit të dhënë me lizing te Lizingmarrësi në fund të afatit të lizingut;
- 2.3. të ekzistoj mundësia për të blerë asetin e dhënë me lizing me një "çmim të pranuar" në fund të afatit të lizingut, ose
- 2.4. vlera aktuale e pagesës së lizingut, e zbritur me një normë të përshtatshme të zbritjes, e tejkalon nëntëdhjetë për qind (90%) të vlerës së drejtë të tregut të asetit.

(Komenti 1: Lidhur me këto kushtet e para, ATK në përgjithësi do të pranojë jetën e dobishmërisë së asetit të dhënë me lizing sikur me qenë e njëjta jetë e dobishmërisë që ATK e lejon për qëllime të zhvlerësimit sipas këtij Ligji. Në mënyrë alternative Lizingdhënësi dhe Lizingmarrësi mund të bëjnë një vlerësim alternativ të jetës së dobishmërisë së një asemi në çdo rast të veqantë, duke u bazuar në vlerësimet e prodhuesit të pajisjes për jetën e dobishmërisë së prititur të pajisjeve të tyre, varësisht prej ndryshimeve në mirëmbajtje dhe në kushtet e punës. Në cilindo rast për shembull nëse një aset është përcaktuar se e ka jetën e dobishmërisë prej 5 vitesh dhe afati i lizingut është më i gjatë se 45 muaj (75% të kësaj jete të dobishmërisë) lizingu do të jetë lizing financiar.)

(Komenti 2: Lidhur me këto kushtet e fundit, vlera aktuale e pagesës së lizingut është vlera e pagesave në datat e tyre të pagesës, të zbritura për të pasqyruar vlerën kohore të parasë. Për shembull, e njeh se pagesa prej 100 euro sot është ekuivalente me pagesën prej 105 euro për kohën prej një viti, sikur të ishte një normë e zbritjes/interetit vjetor prej 5%. Vlera aktuale prej 100 euro që kërkohet të paguhet në periudhën prej një viti me supozimin se norma e interesit/zbritjes prej 5% është 95 euro 23 cent (= 100 euro pagesa e duhur për një vit e ndarë me 105 e cila është 100 euro

nëse tani është kërkuar pagesa dhe plus 5% interes). Për pagesat e lizingut me afat prej dy vitesh, vlera aktuale e kësaj pagese do të ishte 90 euro dhe 70 cent (= pagesa e duhur prej 100 euro për periudhën prej dy vitesh e pjesëtuar me 110.25 e cila do të ishte 100 euro sikurse pagesa të ishte kërkuar tani, plus 5% interesi i shtuar për dy vite). Llogaritjet e vlerës aktuale, duhet të bëhen për çdo pagesë të lizingut me totalin e shumës të këtyre vlerave aktuale, të krahasuara me një shumë të barabartë me 90% të vlerës së drejtë të tregut të asetit të dhënë me lizing, për të përcaktuar lizingun se a është në këto kushte lizing financiar).

3. Lizingjet Financiare janë trajtuar teknikisht si marrëveshje financiare, ku lizingmarrësi blen nga lizingdhënësi asetin e dhënë me lizing. Këto lizingje në përgjithësi trajtohen edhe për qëllime të kontabilitetit edhe për qëllime tatimore, si shitje progresive të asetit të dhënë me lizing nga Lizingdhënësi për Lizingmarrësin, ku Lizingdhënësi trajtohet se po e jep një kredi si avanc për Lizingmarrësin, të cilën Lizingmarrësi e përdor për të blerë asetin e dhënë me lizing. - Për qëllime të tatimit në të ardhurat është:

3.1. shitje progresive e asetit të dhënë me lizing me komponentin e kryegjësë të pagesës së lizingut e cila është e tatueshme për Lizingdhënësin,

3.2. blerje e asetit të dhënë me lizing në fillim të lizingut (ku Lizingmarrësi ka të drejtën që të kërkojë zbritjen e zhvlerësimit në lidhje me asetin e dhënë me lizing), dhe

3.3. kredi nga Lizingdhënësi për Lizingmarrësin, me komponentin e interesit të pagesës së lizingut, që është e vlerësueshme për lizingdhënësin dhe e zbritëshme për Lizingmarrësin. Nuk kërkohet që tatimi në burim në komponentin e interesit të lizingmarrësit të zbritet nga lizingmarrësi kur lizingmarrësi është institucion financiar i autorizuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Shembull:

Kompania A i jep me lizing një automjet të ri Kompanisë B me lizing financiar prej katër vitesh. Sipas lizingut Kompania B është e obliguar që ti paguaj Kompanisë A pagesën e lizingut prej 48 muajsh prej 200 euro, e cila përfshin komponentin e interesit prej 20 euro. Në vitin e parë të lizingut, Lizingdhënësi do të vlerësohet me 2400 euro. (duke qenë, kryegjëja e pranuar 2160 dhe 240 interesi i pranuar gjatë lizingut.) dhe mund të kërkojnë shpenzimet e përvetësimit të asetit të marr me lizing, të zhvlerësuar gjatë jetës së lizingut. Lizingmarrësi do të jetë në gjendje që të kërkojë zhvlerësimin në çmimin total kushtues të automjetit nga viti i parë i lizingut, dhe do të jetë në gjendje që të kërkojë komponentin e interesit (mirëpo jo komponentin e kryegjësë) si zbritje tatimore. Në vitet më të vonshme të lizingut, Lizingdhënësi do të vazhdojë që të pranojë kryegjënë dhe të ardhurat nga interesi, dhe Lizingmarrësi do të vazhdojë që të jetë në gjendje që të kërkojë zhvlerësimin dhe shpenzimet e interesit. Në fund të periudhës së lizingut, çdo opsion i "çmimit të pranueshëm" për të blerë pagesat e bëra nga Lizingmarrësi, do të jenë të vlerësueshme për Lizingdhënësin, dhe Lizingmarrësi do të vazhdojë që të jetë në gjendje që të kërkojë zhvlerësimin mirëpo nuk do të ketë konsekuenca tjera tatimore derisa Lizingmarrësi të shes ose ta largojë në forma tjera automjetin. Nëse Lizingdhënësi i kthehet automjeti, kjo do të trajtohet për qëllime tatimore si "shitje" e automjetit nga lizingmarrësi për Lizingdhënësin me pasojat tatimore, që varen nga shkalla e fitimit apo humbjes në "shitje" të automjetit në atë kohë.

4. "Lizingu Operativ" në paragrafin 1.26 të nenit 2 të Ligjit, është përcaktuar si "çdo lizing që nuk është lizing financiar". Lizingu Operativ i ngjanë marrëveshjes së dhënies me qira të asetit. - Pagesat e lizingut janë plotësisht të zbritëshme për Lizingmarrësin dhe plotësisht të tatueshme për Lizingdhënësin. Meqë lizingdhënësi është pronar i asetit që është dhënë me lizing, lizingdhënësi mund të kërkojë zbritje të zhvlerësimit në pajtueshmëri me dispozitat e zhvlerësimit të këtij Ligji.

Neni 6

Shpenzimet e Palejueshme

1. Paragrafi 1 i Nenit 8 të Ligjit ka të bëjë me shpenzimet e palejueshme. Shpenzimet e mëposhtme janë të palejueshme:

1.1. *Kostoja e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës.* Si parim, toka nuk e humb vlerën e saj në kohë dhe nuk i nënshtrohet prishjes. Toka është lehtë e konvertueshme në para të gatshme. 'Përmirësimi' nënkupton punën që rrit vlerën e tokës dhe që përfshin punën e drenazhës, tarracimit, kanalizimit dhe ujësjellësit dhe vepra të tjera të ngjashme të cilat bëhen pjesë e tokës dhe që e rrisin vlerën totale të tokës.

1.2. *Kostoja e blerjes, përmirësimit, ripërtëritjes dhe rindërtimit të aseteve që janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar ose amortizuar.* Shpenzimet e tilla mbulohen gjatë kohës përmes lejimit të zhvlerësimit dhe amortizimit.

1.3. *Gjobat, ndëshkimet, shpenzimet dhe interesi i lidhur me to.* Shpenzimet e tilla ndodhin kur tatimpaguesit shkelin rregullat e aplikueshme tatimore dhe kërkesat e tjera. Ato do të mbulohen nga fitimi pas tatimit.

1.4. *Tatimi në të Ardhura.* Pagat bruto, përfshirë tatimin në të ardhurat personale, të mbajtur në burim nga të punësuarit, përbëjnë një shpenzim, pra janë të zbritshme. Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave nuk është një zë i zbritshëm sepse ai llogaritet pas zbritjes së të gjitha shpenzimeve të lejuara.

1.5. *TVSH-ja e Zbritshme* nuk është një zë i zbritshëm nëse është rikthyer ose kredituar nga TVSH-ja e llogaritur. Në një rast të veçantë, kjo është një zë I zbritshëm, dhe kjo është kur një tatimpagues për të ardhurat e korporatave, I cili ka bërë zgjedhje për të llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet në baza "reale", nuk e ka arritur pragun e regjistrimit të TVSH-së dhe në këtë mënyrë nuk ka të drejtë të ngarkojë TVSh në furnizimet vendore.

1.6. *Humbjet nga shitja ose këmbimi i pronës ndërmjet personave të lidhur.* Fitimet nga shitja ose këmbimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme në mes personave të lidhur, do të formojnë një pjesë të të ardhurave të tatueshme të palës që e bënë fitimin, ndërsa në të njëjtën kohë pala që e bënë humbjen nuk do të jetë në gjendje ta kërkojë këtë humbje si shpenzim të zbritshëm.

1.7. *Kontributet pensionale mbi shumën maksimale të lejuar me ligj pensional të Kosovës.* Ligji që mbulon pensionet që menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës lejon punëdhënësit të bëjnë kontribute vullnetare të pensioneve për të punësuarit e tyre deri në shumën maksimale prej 15% të pagës bruto të të punësuarit. Kontributet e tilla janë të zbritshme për punëdhënësin, por çdo shumë e tepërt mbi këtë shumë maksimale, nuk është e zbritshme.

Neni 7

Shpenzimet e Lejuara

1. Paragrafi 2, i nenit 9 të Ligjit, parashikon për zbritjen e shpenzimeve të edukimit, të paguara nga një punëdhënës për të punësuarit. Nën-paragrafi 2,4 i këtij neni kërkon që i punësuarit pas përfundimit të edukimit për të cilin janë paguar shpenzimet nga punëdhënësi, të qëndrojnë në marrëdhënie punësimi me punëdhënësin për një periudhë minimale. Për qëllime të këtij nën-paragrafi, periudha minimale do të jetë 24 muaj.

2. Nëse një i punësuar, pas përfundimit të edukimit për të cilin punëdhënësi i asaj /atij ka paguar shpenzimet, e lëshon punën para 24 muajve atëhere nëse:

2.1. nëse i punësuar i ka paguar plotësisht punëdhënësin për shpenzimet e edukimit, punëdhënësi do të vlerësohet për ripagesën në vitin në të cilin është bërë ripagesa, dhe nuk bëhet ndryshim në zbritjet tatimore të kërkuara në lidhje me këto shpenzime;-

2.2. nëse i punësuar i ripaguan punëdhënësin pjesërisht për shpenzimet e edukimit, punëdhënësi do të vlerësohet për ripagesën e pjesërishtme në vitin në të cilin është bërë ripagesa, dhe shpenzimet e zbritëshme të punëdhënësit në vitin kur e ka lënë punën i punësuar, do të zvogëlohen nga bilanci i shumës së shpenzimeve të edukimit të zbritura më parë).

2.3. nëse i punësuar nuk e ka ripaguar punëdhënësin për shpenzimet edukative, shpenzimet e zbritëshme të punëdhënësit në vitin kur i punësuar i lëshon punën do të zvogëlohen nga shumata e shpenzimeve edukative të zbritura më parë).

3. Paragrafi 6 i nenit 9 të Ligjit, i referohet shpenzimeve në lidhje me lizingun operativ dhe financiar. Shpenzimet e tilla, do të jenë të zbritshme bazuar në atë që është paraqitur në nenin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ.

4. Paragrafi 7 i nenit 9 të Ligjit parasheh që, në mënyrë që shpenzimet të lejohen si të zbritshme, të gjitha shpenzimet duhet të jenë plotësisht të dokumentuara me dokumente të tilla në dispozicion për inspektim, me kërkesë nga Administrata Tatimore. Kërkesat për dokumentacion për shpenzimet e lejueshme janë paraqitur në nenin 23 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 Për Zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat .

Neni 8 Zbritjet e Lejuara

1. Në paragrafin 1 të nenit 10 të Ligjit, shprehja *'të llogaritura para se të jenë zbritur kontributet e bamirësisë'* do të thotë se do të aplikohet limiti i lejuar prej 5% në fitimin bruto, përpara se një shpenzim i këtyre të jetë zbritur nga të ardhurat e rregulluara bruto.

Shembull:

Nëse një kompani ka një fitim bruto, përpara kontributeve bamirëse prej 10.000 € dhe ajo ka bërë një donacion në një spital prej 400 € do të aplikohet limiti i lejuar prej 5% në 10.000 euro dhe jo në $10.000 - 400 = 9.600$ €. Në këtë rast 400 € janë plotësisht të zbritshme sepse janë brenda limitit të lejuar prej $10.000 \times 5\% = 500$ €.

2. Në paragrafin 4 të nenit 10 të Ligjit, tatimpaguesit të cilët kërkojnë një zbritje në lidhje me kontributet bamirëse të bëra gjatë periudhës tatimore, në kohën e deklarimit të deklaratës vjetore tatimore do të sigurojnë edhe pasqyrat financiare përkatëse, kuponët e nënshkruar dhe vulosur nga ana e përfituesve të kontributeve bamirëse, që vërtetojnë qëllimin e atyre donacioneve, shumata e atyre donacioneve dhe kohën kur janë bërë donacionet. Një zbritje e kontributit bamirës mund të kërkojë vetëm nga ata tatimpagues që paguajnë tatim në baza të të ardhurave reale, dhe që veç janë të detyruar të dorëzojnë një deklaratë tatimore vjetore. Tatimpaguesit me tatim të paragjykuar nuk mund të kërkojnë këtë zbritje.

3. Çdo kupon i referuar në paragrafin e mëparshëm duhet të përmbajë informatat si në vijim:

3.1. emrin e donatorit;

- 3.2. numrin identifikues tatimor (numrin fiskal) të donatorit, ose kur donatori është individ që nuk është i detyruar të ketë numër fiskal, numrin personal të identifikimit të individit;
- 3.3. adresën e donatorit;
- 3.4. emrin kontaktues të personit të donatorit dhe numrin e telefonit;
- 3.5. emrin e pranuesit;
- 3.6. numrin identifikues tatimor (numrin fiskal) të pranuesit;
- 3.7. adresën e pranuesit;
- 3.8. emrin e personit kontaktues të pranuesit dhe numrin e telefonit;
- 3.9. shumën e kontributit bamirës të dhuruar;
- 3.10. datën e donacionit;
- 3.11. deklaratën e pranuesit se të dhënat në kupon janë të sakta dhe se pranuesi nuk ka konflikt direkt apo indirekt të interesit me donatorin.

Neni 9

Shpenzimet e Përfaqësimit

1. Neni 11 i Ligjit parasheh zbritje në lidhje me shpenzimet e përfaqësimit, por e kufizon këtë në 50% të shumës së faturuar për argëtim të biznesit. Kjo zbritje, dhe kufizimet e saj, zbatohen në lidhje me shpenzimet argëtuuese të biznesit. Shpenzimet e përfaqësimit të biznesit siç janë ato për publicitet, reklamim, për promovimin dhe përfaqësimin e produkteve pa elemente argëtimi, ndryshe nga ato të rastit, janë plotësisht të zbritëshme sipas dispozitave të zbritjes së shpenzimeve të përgjithshme të biznesit.

2. Në mënyrë që të lejohet ndonjë zbritje për shpenzimet e përfaqësimit, sipas nenit 11 duhet të zbatohet një nga këto:

- 2.1. shpenzimet të jenë shkaktuar kryesisht në lidhje me biznesin;
- 2.2. argëtimi është për një klient ose furnizues ekzistues apo të ardhshëm;
- 2.3. rrethanat e bëjnë të nevojshme për të diskutuar punën së bashku me argëtim, si një drekë biznesit ku qëllimi kryesor është biznesi;
- 2.4. punonjësit janë argëtuar për të ruajtur vullnetin e mirë të personelit në ngjarje të tilla, si ahengjet dhe rastet e daljes në pension.

3. Zbritja për shpenzimet e argëtimit në bazë të nenit 11, zbatohet në lidhje me zbavitjet afariste. Shpenzimet private për argëtim nuk janë të zbritshme, p.sh. drekat në restorant me miqtë, ose kur aspekti i biznesit ose profesionale është i rastit.

4. Zbritja për shpenzimet e argëtimit, në bazë të nenit 11 zbatohet në lidhje me shumat e faturuara. Në mënyrë që të lejohet një zbritje, duhet të ketë një faturë, që mbulon shpenzimet për argëtim. Tatimpaguesit duhet të jenë në gjendje për të mbështetur këto kërkesa për shpenzime duke qenë në gjendje për të siguruar, kur të kërkohet nga ATK, të dhënat e mëposhtme:

- 4.1. datën kur kanë ndodhur shpenzimet
- 4.2. emrat e personave që kanë marrë pjesë në argëtim;
- 4.3. bizneset që përfaqësojnë këta persona ;
- 4.4. pozicionet që kanë këta persona në këto biznese, dhe
- 4.5. arsyet për argëtim.

5. Shpenzimet e reprezentacionit në bazë të nenit 11, janë 50% të zbritshme deri në shumën e barabartë me 2% të të ardhurave vjetore bruto. Shprehja *Të Ardhurat Vjetore Bruto* në atë nenë, do të thotë të gjitha të ardhurat që janë krijuar gjatë periudhës tatimore nga burimet mbrenda në Kosovë, dhe kjo përfshin të ardhurat nga veprimtaria e biznesit, të ardhurat nga përdorimi I

pasurisë së luajtëshme, paluajtshme ose të paprekshme të ardhurat nga interesi, të ardhurat nga dividatat, fitimi nga shitja e letrave me vlerë ose të paluajtshme, dhe të gjitha të ardhurat e tjera pavarësisht nëse ato i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat ose jo.

Neni 10 **Borxhet e Këqija**

1. Nën-paragrafi 1.2 i nenit 12 të Ligjit kërkon që borxhet e këqija të "shlyhen". Në terminin e kontabilitetit "shlyhen" do të thotë që është bërë një rregullim në librat e tatimpaguesve për të reflektuar uljen e vlerës së llogarive të arkëtueshme (zakonisht me anë të një llogarie, Dispozita për Borxhet). Shuma e përfshirë në dispozitat për llogarinë e borxhit të keq, është e bazuar në të dhënat historike, dhe kur të jetë zbritur shumën e përkohshme nga llogaria e llogaris së arkëtueshme jep një perspektivë më të mirë për të ardhurat që një tatimpaguesi mund të pres për të marrë nga llogaria e tij e arkëtueshme. Megjithatë, për qëllime tatimore, shpenzimi për borxhet e këqija nuk mund të kërkojë bazuar në llogarinë e përkohshme. Duhet të jetë bërë një rregullim në librat e tatimpaguesit për të pasqyruar shpenzimin aktual të borxhit të keq, duke u bazuar në ato borxhe të veçanta që i plotësojnë kushtet për të qenë shpenzime (dmth, një borxh duhet të jetë gjashtë muaj i vjetër, duhet të ketë prova të mjaftueshme të përpjekjeve të konsiderueshme të pasuksesshme për të vjelë borxhin, etj). Nuk ka asnjë shpresë që tatimpaguesi duhet të heq dorë nga çdo përpjekje në të ardhmen për të mbledhur borxhin. Siç është paraparë në paragrafin 2 të nenit 12 të Ligjit, çdo borxh i keq që është zbritur si shpenzim dhe që është mbledhur më vonë do të përfshihet në të ardhurat në periudhën tatimore në të cilën është bërë mbledhja.

2. Lidhur me nën-paragrafin 1,5 të nenit 12 të Ligjit "*dëshmi adekuate*" - përfshinë:

2.1. vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente që vërteton se borxhi është i pambledhshëm;

2.2. kur veprimet ligjore nuk janë me kosto efektive, evidencë me shkrim ose të vendimit për të trajtuar një borxh të veçantë si borxh të keq pa marrjen e veprimeve ligjore për shkak të asaj arsyeje, ose më në përgjithësi një politikë interne e cila trajton llojet e caktuara të borxheve si të këqija pa ndërmarrjen e veprimeve ligjore për shkak të asaj arsyeje, në të dyja rastet me kusht që Administrata Tatimore e Kosovës është e kënaqur, dhe se pragu i aplikuar në përcaktimin se nëse veprimet ligjore janë me kosto efektive ose jo është i arsyeshëm për rrethanat;

2.3. kur veprimet ligjore nuk do të jenë të mundshme, evidencë me shkrim ose e vendimit për të trajtuar borxhin specifik si të keq pa ndërmarrë veprime ligjore për shkak të asaj arsyeje apo më në përgjithësi një politike interne e cila trajton llojet e caktuara të borxheve si të këqija pa ndërmarrjen e veprimeve ligjore për shkak të asaj arsyeje;

2.4. vërtetimin zyrtar të veprimeve të pasuksesshme të mbledhjes së detyrueshme;

2.5. certifikatën nga policia, ose agjencionet e tjera të zbatimit të ligjit për të provuar se borxhliu i tatimpaguesit nuk ka gjurmë;

2.6. certifikatën e Zyrës Civile që dëshmon se tatimpaguesi ka vdekur, dhe

2.7. çdo dokument tjetër zyrtar që mbështet krijimin e dispozitës së borxhit të keq.

Neni 11 **Pagesat për Personat e Lidhur**

Neni 14 i Ligjit parasheh që kompensimi, pagat, interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera të paguara për personat e lidhur lejohen si zbritje në një shumë të barabartë me shumën më të vogël të paguar dhe vlerën përkatëse të tregut të hapur.

Shembulli 1:

I biri i pronarit të një kompanie është i punësuar nga kompania si shofer dhe paguhet 2.000 €/muaj. Vlera e tregut për shërbime të vozitjes është 400 €. Kjo është shuma që do të lejohet si zbritje meqë shoferi dhe kompania janë persona të lidhur.

Shembull 2:

Kompania A dhe B janë në pronësi nga individ i njëjtë dhe A i jep me qira një depo B-s për 1,000 euro / muaj. Vlera e tregut për një shërbim të tillë me qira është 1.800 €. Vetëm 1.000 € lejohet si shpenzim i zbritshëm meqë A dhe B janë persona të lidhur.

Neni 12 Zhvlerësimi

1. Shprehja "*Në Pronësi të Tatimpaguesit*" në paragrafin 1 të nenit 15 të Ligjit nënkupton që vetëm pronari i pasurive të prekshme, i cili mban rrezikun e konsumimit, prishjes apo vjetërimit të mjeteve, ka të drejtë të zbres shpenzimet e zhvlerësimit. Nuk lejohet zbritja e zhvlerësimit për qiramarrësin e aseteve, përveç nëse është përcaktuar në marrëveshjen e qirasë se është i përfshirë lizingu financiar dhe të drejtat e pronësisë kalojnë mbi qiramarrësin nga qiradhënësi përmes pagesave periodike.

2. Sipas paragrafit 2, të nenit 15 të Ligjit, shpenzimet për përmirësimin e pronës së dhënë me qira mbulohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit duke përdorur Metodën Lineare të bazuar në kohëzgjatjen e kontratës së qirasë. Në rastin e kontratave pa kufizim të qirasë, ose kur kohëzgjatja e kontratës së qirasë zgjatet shpesh, qiramarrësi sipas gjykimit të tij apo të saj më të mirë, dhe bazuar në rregullat e kontabilitetit dhe praktikat më të mira, duhet të përcaktoj kohëzgjatjen e kontratës së qirasë dhe ta shfrytëzojë atë si emërues për llogaritjen e shpenzimeve vjetore të zhvlerësimit për përmirësim.

3. Paragrafi 4 i nenit 15 të Ligjit parashikon që për zhvlerësim të përdoret metoda lineare. Duke pasur parasysh normat e zhvlerësimit për secilën kategori të aseteve (siç janë kategorizuar në paragrafin 3 të nenit 15), kjo do të thotë Kategoria 1 e aseteve të reja (norma e zhvlerësimit 5%) do të zhvlerësohet në shuma të barabarta gjatë 20 periudhave tatimore, Kategoria 2 e aseteve (Shkalla e zhvlerësimit 20%) do të zhvlerësohet në shuma të barabarta gjatë 5 periudhave tatimore, dhe Kategoria 3 e re e aseteve (norma e zhvlerësimit 10%) do të zhvlerësohet në shuma të barabarta gjatë 10 periudhave tatimore.

Shembull: Të supozojmë se kompania X në fillim të periudhës tatimore 2010 blen një ndërtesë prej 1.000.000 € e cila i përket Kategorisë 1 të aseteve të zhvlerësueshme (e cila lejon zhvlerësimin e 5% të vlerës së secilit aset në fund të periudhës tatimore). Metoda lineare funksionon si në vijim:

| Periudha tatimore | Bilanci fillestar | Shtesat | Zhvlerësimi | Bilanci i mbylljes |
|-------------------|-------------------|---------|-------------|--------------------|
| 2010 | | 1000000 | - 50,000 | 950,000 |
| 2011 | 950,000 | | -50,000 | 900,000 |
| 2012 | 900,000 | | - 50000 | 850,000 |
| 2029 | 50.000 | | - 50.000 | 0 |

4. Paragrafi 5, i Nenit 15 të Ligjit parasheh, që asetet së pari duhet të merren parasysh për qëllime të zhvlerësimit vetëm kur ato janë të vendosura në shërbim. Nuk do të lejohet zbritje për zhvlerësim nëse një aset nuk është vënë në shërbim dhe në qoftë se nuk i shërben qëllimit të aktivitetit ekonomik. Zhvlerësimi i vitit të plotë mund të kërkohet në lidhje me asetet që janë vënë në shërbim gjatë gjashtë muajve të parë të një viti, por vetëm zhvlerësimi i gjysmës së vitit mund të kërkohet në lidhje me asetet e vëna në shërbim në gjashtë muajt e fundit të një viti. Në të dy rastet zhvlerësimi i plotë për vitin mund të kërkohet në vitet vijuese deri në, mirëpo duke mos e përfshirë vitin në të cilin është shitur aset i ose është sistemuar në ndonjë mënyrë tjetër – në vitin e shitjes ose të sistemimit fitimi ose humbja në shitje mund të njihet bazuar në krahasimin ndërmjet çmimit të shitjes/sistemimit dhe vlerës kontabël të asetit në fillim të vitit të shitjes/sistemimit.

Shembull:

Kompania X blen dy makina gjatë 2010, secila nga 5000 €, por e para është blerë më 15 prill 2010 dhe e dyta me 20 shtator 2010. Zhvlerësimi që mund të kërkohet në periudhën tatimore 2010 në lidhje me makinën e parë do të jetë e drejta për vitin e plotë prej 1,000 euro (20%), ndërsa për makinën e dytë mund të kërkohet vetëm zhvlerësimi i gjysmës së vitit (500 €). Të dy makinat do të kenë të drejtë të kërkojnë zhvlerësimin për vitin e plotë nga viti 2011 e tutje (me përjashtim se makina e dytë do të merr vetëm zhvlerësimin për gjysmën e vitit në periudhën e saj finale të zhvlerësimit-gjysmën e parë të vitit 2015).

5. Paragrafi 7 i nenit 15 të Ligjit parasheh që asetet e Kategorise 2 dhe 3 (siç janë kategorizuar në paragrafin 3 të nenit 15) zhvlerësohen individualisht, duke përdorur metodën lineare kur është siguruar pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit. Për arsye praktike kjo vlen për asetet që janë siguruar më ose pas 1 janarit 2010. Paragrafi 8 i nenit 15 parashikon që asete në këto kategori të cilat janë blerë para kësaj date dhe janë zhvlerësuar sipas metodës së grupimit, vazhdojnë të zhvlerësohen sipas asaj metode derisa vlera e grupit të bëhet zero.

Shembull:

Të supozojmë se kompania X në fillim të periudhës tatimore 2010 posedon asetet vijuese që i përkasin Kategorisë 2: 10 kompjuterë - secili 1.000 €, 2 fotokopjuese – secila nga 4.000 €, 2 automobila – secili nga 10,000 €. Në gjysmën e parë të periudhës tatimore 2010, kompania blen një tjetër fotokopjuese për 5.000 €.

Kategoria 2 e aseteve të para, të cilat kanë një bilanc të hapjes në grup prej 38.000 € do të zhvlerësohet duke shfrytëzuar metodën lineare me normën prej 20% për vit, derisa vlera e grupi të arrijë në zero.

Fotokopjuesi i blerë në vitin 2010 për 5.000 € do të zhvlerësohet në mënyrë individuale duke përdorur metodën lineare me normën prej 20% (1.000 €) në vit.

6. Paragrafët 9 dhe 10 të nenit 15 të Ligjit, parashohin rregulla të veçanta për asetet e reja me çmim të blerjes deri në 3.000 €. Asetet me një çmim blerjeje prej 1,000 euro ose më pak mund të jenë shpenzime të plota në periudhën tatimore në të cilën ato janë blerë dhe janë vënë në shërbim. Asetet me një çmim të blerjes prej 1000 dhe 3.000 € duhet të regjistrohen në një grup të ri (në vend që të zhvlerësohen individualisht si asete të Kategorisë 1, 2 ose 3) të cilat do të zhvlerësohen bazuar në metodën lineare duke përdorur normën prej 20%. Meqë janë blerë asete shtesë me çmim prej 1.000 deri në 3.000 €, çmimi i blerjes së tyre do të shtohet vlerës së grupit. Nëse asetet e tilla shiten në grup, çmimi i blerjes së asetit të shitur do të raportohet si e ardhur e zakonshme e biznesit në periudhën tatimore në të cilën është shitur aset i, por vlera e grupit nuk do të ulet si rezultat i shitjes.

Shembull:

Të supozojmë se kompania X blen një kompjuter në fillim të vitit 2010 për 2000 € dhe një artikull për fabrikë, dhe makineri në fillim të vitit 2011 për 2.400 €. Ajo shet kompjuterin për 1.000 € në vitin 2012.

Secila nga këto asete i plotëson kriteret për t'u përfshirë në grupin e autorizuar sipas paragrafit 10 të nenit 15. Llogaria e grupit do të veprojë si vijon:

| Periudha tatimore | Bilanci i hapjes | Shtesat | Reduktimi | Zhvlerësimi | Bilanci i mbylljes |
|-------------------|------------------|---------|-----------|-------------|--------------------|
| 2010 | | 2000 | | - 400 | 1600 |
| 2011 | 1600 | 2400 | | - 800 | 3200 |
| 2012 | 3200 | | | - 640 | 2560 |

Për periudhën tatimore 2012, do të përfshihen 2000 € (çmimi i blerjes së kompjuterit), në të ardhurat e tatueshme, por nuk do të bëhet rregullim në llogarinë e grupit e cila do të vazhdojë të aplikohet me 20% të zhvlerësimit të aplikuar në bilancin e hapjes së grupit, plus çdo shtesë në çdo periudhe tatimore.

7. Rregulla e përgjithëshme për përcaktimin e saktë të zhvlerësimit për qëllime tatimore, është se zhvlerësimi i aseteve duhet të bazohet në çmimin e kostos historike. Megjithatë duke pasur parasysh rrethanat e periudhës pas luftës në Kosovë, Drejtori i Përgjithshëm i ATK mund të nxjerr një shpjegim të përgjithshëm për ndërmarrjet me pronësi shoqërore apo publike duke lejuar bazën e rivlerësuar, nëse ai ose ajo konsideron se në ato rrethana duhet të aplikohet një qasje alternative.

Neni 13 Zhvlerësimi i Bagëtisë

1. Paragrafi 3.2 i nenit 15 të Ligjit lejon zbritjen e zhvlerësimit për bagëtinë që shfrytëzohet në aktivitet ekonomik për riprodhim ose mbarështim. Kjo zbritje nuk vlen për:

1.1. bagëtinë e rritur nga tatimpaguesi- në këto raste nuk ka bazë zhvlerësimi meqë kostoja e rritjes së kësaj bagëtie veq është zbritur.

1.2. bagëtinë e blerë për rishitje- në këto raste kjo bagëti do të regjistrohet si pjesë e inventarit të tatimpaguesit dhe zbritjet e lejuara si pjesë e llogaritjeve të “kostos së mallrave të shitura” (p.sh zbritja lejohet për çdo vit për inventarin hyrës, plus blerjet pa inventarin e mbylljes.

1.3. bagëtinë që nuk është blerë për rishitje, e cila e ka koston e blerjes prej 1000 euro ose më pak- kjo bagëti është e mundur të kërkohet si shpenzim rrjedhës në vitin e blerjes sipas paragrafit 9 të nenit 15 të Ligjit.

1.4. Bagëtinë që nuk është blerë për rishitje e cila e ka çmimin e blerjes ndërmjet 1000 dhe 3000 euro e cila është blerë me 1 janar ose pas 1 janarit 2010 – zbritjet e zhvlerësimit për këtë bagëti janë të lejueshme si pjesë e grupit të aseteve të parapara në paragrafin 10 të nenit 15 të Ligjit.

1.5. Duke pasur parasysh si më lartë, zbritja e zhvlerësimit e lejuar sipas paragrafit 3,2 të nenit 15, dhe sipas nenit 16, në praktikë do të jetë e kufizuar për bagëti me vlerë të lartë ,

normalisht për ato me racë të qmuar. Në këto raste, zbritja e lejueshme e zhvlerësimit, sikur me kategorinë tjetër të asetëve 2 është 20% e çmimit të blerjes për vit në baza lineare.

Neni 14 **Zbritjet e Posaçme për Asetet e Reja**

Paragrafi 1 i nenit 17 të Ligjit parasheh që fabrika dhe makineritë, inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanët, anijet, mjetet e rënda të transportit, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda të reja, të blera në vend ose të importuara për herë të parë në Kosovë në mes të 1 janarit 2010 dhe 31 dhjetorit 2012, do të përfitojnë nga lejimi i veçantë prej 10%, përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm.

Shembull:

Të supozojmë se Kompania X ka një bilanc të hapjes në Kategorinë 3 për periudhën tatimore 2010 prej 160,000 € Gjatë gjysmës së parë të vitit kompania importon nga Gjermania një automjet të ri të rëndë për transport prej 40.000 € Zbritja e zhvlerësimit për këtë periudhë tatimore do të ketë tre komponenta:

1. Zhvlerësim i makinës së re si një aset individual: $40.000 \times 10\% = 4.000 \text{ €}$;
2. Zhvlerësimi asetëve në grup të kategorisë 3 në dorë në fillim të periudhës tatimore 2010: $160.000 \times 15\% = 24.000 \text{ €}$
3. Lejimet e posaçme për automjetin e ri: $40.000 \times 10\% = 4.000 \text{ €}$

Zbritja totale e zhvlerësimit prej 32000 € Lejimi i posaçëm për automjetin e ri është dhënë vetëm një herë, në periudhën tatimore në të cilën është blerë në Kosovë apo sjell në Kosovë.

Neni 15 **Riparimet dhe Përmirësimet**

1. Neni 18 i Ligjit merret me riparimet dhe përmirësimet. Termi '*riparime ose përmirësimet*' nënkupton punën që është bërë për të rritur dukshëm kapacitetin, jetën, kushtet dhe produktivitetin e asetit. Në rastin e një ndërtese, mbulimit, futjes së ujësjellësit, suvatimit dhe punë të tjera të ngjashme konsiderohen riparime dhe përmirësimet, por ngjyrosja nuk është. Në rastin e një kamioni, ndërrimi i gomave nuk është përmirësim, por zëvendësimi i motorit ekzistues me një të ri, është riparim dhe përmirësim.

2. Paragrafi 1 i nenit 18 të Ligjit parasheh që shumat e shpenzuara për riparime ose përmirësimet të një asemi do të kapitalizohen dhe do të shtohen bazës së shpenzimeve të zhvlerësueshme të asetit, nëse riparimet ose përmirësimet e tejkalojnë jetën e përdorimit të asetit për së paku një vit, dhe shuma e riparimit apo përmirësimi është më e madhe se 1.000 € Në ato situata kur riparimet ose përmirësimet e zgjasin përdorimin e asetit për një vit ose më shumë, dhe shuma e shpenzuar për riparime ose përmirësimet është më e madhe se 1.000 €, shuma e plotë e shpenzuar është e nevojshme për tu kapitalizuar (1.000 € prej kësaj shume nuk lejohet që të kërkohet si shpenzim). Në anën tjetër, në ato situata kur riparimet ose përmirësimet nuk e zgjasin jetën e përdorimit të asetit, ose e zgjasin atë për më pak se një vit, shumat e përfshira mund të kërkohen si shpenzim i plotë edhe kur shumat kalojnë 1.000 €

3. Paragrafi 2 i nenit 18 të Ligjit, parashikon rregullat për llogaritjen e zhvlerësimit, ku shumat e shpenzuara për riparime ose përmirësimet të një aseti kapitalizohen.

3.1. Për riparimet e bëra për kategorinë 1 të aseteve kurdo që të jenë blerë, dhe për riparimet e bëra për kategorinë 2 dhe 3 të aseteve të blera më ose pas hyrjes në fuqi të Ligjit, shumat e kapitalizuara për riparim i shtohen vlerës së mbetur kontabël të asetit.

Shembull:

Supozoni se vlera fillestare kontabël e ndërtesës së tatimpaguesit është 100.000 € Gjatë vitit tatimor 2010 tatimpaguesi shpenzon 4.000 € në riparimin e kulmit të cilat e zgjasin jetën e përdorimit të ndërtesës për pesë vjet të tjera. Zhvlerësimi për ndërtesën për vitin tatimor 2010 llogaritet si vijon:

vlera kontabël fillestare e objektit 100.000 € riparimet dhe përmirësimet e kapitalizuara 4,000

| | | | |
|---|---------|-------------|----|
| vlera kontabël e mbylljes para zhvlerësimit | 104,000 | Zhvlerësimi | 5% |
| 5,200 vlera kontabël e mbylljes e ndërtesës | | 98,800 | |

3.2. Për riparimet e bëra në Kategorinë 2 dhe Kategorinë 3 të aseteve të blera para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, shumat e kapitalizuara të riparimeve janë:

3.2.1. kur shuma e riparimit është ndërmjet 1000 dhe 3000 euro, e shtuar grupit të referuar në paragrafin 10 të nenit 15 të Ligjit si asete të reja të kualifikuara

3.2.2. kur shuma e riparimit është mbi 3000 euro, e trajtuar si kategoria e re 2 ose kategoria 3 e aseteve, nëse aplikohet, për të cilat do të lejohet zhvlerësimi si zbritje në pajtueshmëri me paragrafin 4 të nenit 15 të Ligjit.

Neni 16

Shpenzimet Kërkimore dhe Zhvillimore

1. Paragrafi 1 i nenit 20 të Ligjit parashikon zhvlerësimin e një rezerve natyrore të mineraleve dhe burimeve të tjera natyrore. Shfrytëzuesi i rezervës mund të kërkojë zbritje për shpenzimet e eksplorimit dhe zhvillimit. Shpenzimet për hulumtim, shpenzimet e zhvillimit dhe interesi përkatës, duhet të shtohen në llogarinë kapitale ashtu si kanë ndodhur. Në fund të periudhës tatimore, pjesa e shpenzimeve të eksplorimit dhe zhvillimit që i përkasin asaj periudhe, do të përcaktohet duke shumëzuar bilancin në llogarinë kapitale me Koeficientin e Zhvlerësimit (në vijim KZH) i cili është:

Numri i njësive të nxjerra gjatë vitit

KZH = _____

Totali i vlerësuar i njësive në rezerva

Shembull:

Kompania X ka marrë me qira një fushë bakri dhe numri i vlerësuar i njësive në rezervat natyrore është 15.000.000. Prodhimi për vit është 1.500.000 njësi. Bilanci në llogarinë kapitale në fund të periudhës tatimore është 500,000 €. Për të përcaktuar shumën e lejuar të zhvlerësimit për periudhën tatimore, bilanci në llogari duhet të shumëzohet me KZH. Në këtë rast, koeficienti është 10%, (1.500.000 / 15.000.000). Prandaj zhvlerësimi i lejuar si zbritje, është €50,000.

1. 2. Për të përcaktuar totalin e numrit të njërive në rezerva, tatimpaguesi duhet të marrë një raport nga ekspertët, dhe nëse kërkohet duhet ta vejë atë në dispozicion për ATK për inspektim, apo të dorëzohet me deklaratën tatimore vjetore. Llogaritja e njërive të nxjerrjes duhet të bëhet duke përdorur metoda të pranuar në përgjithësi. ATK e ruan të drejtën për të përdorur shërbimet e specialistëve të pavarur për të rishikuar raportet inxhinierike dhe metodat e llogaritjes së nxjerrjes.

Neni 17

Fitimet apo Humbjet Kapital

1. Paragrafi 4 i Nenit 21 të Ligjit kërkon përdorimin e vlerës së hapur tregut ku shitjet e aseteve kapitale janë bërë në mes personave të lidhur me çmime të shitjes që janë më të ulëta se vlera e hapur e tregut. Në raste të tilla, vlera e hapur e tregut duhet të përcaktohet si:

1.1. shuma monetare e parashikuar për një shitje të asetit të njëjtë në mes të blerësit të vullnetshëm dhe shitësit të vullnetshëm në një transaksion të mbizotërimit të tregut

1.2. ose, kur kjo më sipër nuk është në dispozicion, shumat që do të lindin nga shitja e një asemi të ngjashëm në rrethana të ngjashme (p.sh. cilësi të ngjashme, madhësi të ngjashme ose periudhë kohore dhe kushte të njëjta të shitjes)

1.3. ose, kur nuk aplikohen asnjëra më lart, një metodë e miratuar nga ATK, e cila siguron një përafrim të mjaftueshëm objektiv.

1.4. Metoda e lejueshme nga ATK sipas opcionit të fundit nga ato më lartë, është e bazuar në koston plus, me shpenzimet të cilat janë të punës dhe materialit, plus përqindja e shpenzimeve të përgjithshme dhe pastaj përqindja e arsyeshme e marzhës. Tatimpaguesit të cilët dëshirojnë të përdorin këtë metodë duhet të sigurojnë ATK-në me dokumentacion që tregon se pse ata nuk mund të përdorin dy opsionet e mëparshme.

2. Paragrafi 13 i nenit 21 të Ligjit, mbulon shitjet e aseteve kapitale që përfshijnë marrëveshjet me këste të cilat shtrihen në më shumë se një periudhë tatimore. Në raste të tilla fitimet ose humbjet kapitale duhet të raportohen në baza lineare gjatë kohës së marrëveshjes me këste, duke filluar nga data më e hershme e pagesës së depozitit, ose nga data kur ky depozit e ka afatin dhe duke përfunduar në datën më të hershme të pagesës së këstit të fundit ose datës kur e ka pasur afatin kjo pagesë.

3. Në bërjen e këtyre llogaritjeve në baza lineare:

3.1. kur data e fillimit për marrëveshjen me këste bjen brenda 6 muajve të parë të viti, data fillestare e marrëveshjes me këste konsiderohet se është dita e parë e vitit;

3.2. kur data e fillimit të marrëveshjes me këste bie në 6 muajt e dytë të vitit, datat e fillimit konsiderohet se është dita e parë e kësaj periudhe gjashtë mujore;

3.3. kur data e fundit e marrëveshjes me këste bie në 6 muajt e parë të vitit, data e fundit konsiderohet se është dita e fundit e kësaj periudhe 6 mujore;

3.4. kur data e fundit e marrëveshjes me këste bjen në 6 mujorin e dytë të vitit, data e fundit e marrëveshjes me këste konsiderohet se është dita e fundit e atij viti;

3.5. çdo pagesë e këstit kur shuma e pagesës nuk është e sigurtë derisa të ndodhë ngjarja e veçantë (p.sh. kur një pjesë e çmimit të shitjes/blerjes është pjesë në arritjen e nivelit të caktuar të shitjes ose ndonjë ngjarje tjetër kur ekziston mundësia që kjo e arritur ose ngjarje nuk do të ndodhë) duhet të injorohet – njohja e të ardhurave jo të sigurta për shitësin, dhe

kostoja e pa caktuar për blerësin në këto rrethana do të lindë vetëm nëse dhe kur pjesa të jetë larguar dhe shuma e pagesës bëhet e sigurtë.

Shembulli 1:

Nëse një aset kapital e ka vlerën neto (kostoja e përvetësimit plus kostoja e përmirësimit pa zhvlerësimin e kërkuar për qëllime tatimore) në libra prej 5,000 euro dhe është shitur për 7,000 euro, kjo rezulton në fitimin kapital prej 2,000 euro. Nëse marrëveshja e shitjes parasheh pagesat e kësteve që janë bërë gjatë periudhës nga 1 prilli 2010 deri më 31 Mars 2012 (periudhë prej dy viteve që shtrihet në tri vite tatimore), atëhere fitimi kapital do të njihet si në vijim:

në bërjen e llogaritjeve lineare, marrëveshja me këste do të trajtohet se ka filluar me 1 janar 2010 dhe se ka përfunduar me 30 qershor 2012, periudhë prej 30 muajsh

shuma e fitimit e regjistruar për vitin 2010 do të jetë $2,000 \times 12/30 = 800$ euro

shuma e fitimit e regjisitruar për vitin për vitin 2011 do të jetë $2,000 \times 12/30 = 800$ euro

shuma e fitimit e regjisitruar për vitin për vitin 2012 do të jetë $2,000 \times 6/30 = 400$ euro.

Shembulli 2:

Nëse aset kapital në libra e ka vlerën neto prej 9,000 euro dhe është shitur për 6,000 euro, kjo rezulton në humbje kapitale prej 3,000 euro. Nëse marrëveshja e shitjes parasheh pagesat e kësteve që janë bërë gjatë periudhës prej 1 tetorit 2010 deri më 30 shtator 2012, atëhere humbja kapitale do të organizohet si në vijim:

për të bërë llogaritjet në baza lineare, marrëveshjet e kësteve do të trajtohen se kanë filluar me 1 korrik 2010 dhe se kanë përfudnuar me 31 dhjetor 2012, periudhë prej 30 muajsh

shuma e humbjes së regjistruar për vitin 2010 do të jetë $3,000 \times 6/30 = 600$ euro

shuma e humbjes së regjistruar për vitin 2011 do të jetë $3,000 \times 12/30 = 1,200$ euro

shuma e humbjes së regjistruar për vitin 2012 do të jetë $3,000 \times 12/30 = 1,200$ euro.

Neni 18 **Humbjet Tatimore**

1. Paragrafi 5 i nenit 23, i Ligjit parasheh që humbjet tatimore të krijuara në një vit tatimor, në përgjithësi do të jenë në gjendje që të barten dhe thyhen kundrejt të ardhurave të tatueshme në vitet vijuese të të njëjtit biznes që e ka krijuar humbjen. Ky paragraf gjithashtu parasheh se nuk lejohet bartja e humbjeve kur biznesi e ndryshon llojin e tij të organizimit të biznesit (p.sh biznesi ndryshon prej funksionimit si ndërmarrje personale individuale në ortakëri ose në një entitet juridik të inkuorporuar) ose kur ka ndryshim në pronësi prej më shumë se 50%.

1.1. Në lidhje me ndryshimet e organizatës së biznesit, përjashtimi nga rregulla e përgjithshme që humbjet tatimore më nuk do të jenë në gjendje të barten, vlen kur një tatimpagues tjetër “përvetëson” tatimpaguesin sipas “riorganizimit” të aprovuar nga ATK sipas nenit 26 të Ligjit, në q’rast humbjet tatimore të krijuara nga tatimpaguesi para riorganizimit mund të kërkohen nga tatimpaguesi që e ka bërë përvetësimin në vitin vijues.

1.2.Në lidhje me ndryshimet e pronësisë, në mënyrë që të barten humbjet gjatë periudhës që fillon me ditën e parë të vitit tatimor me humbje, deri në ditën e fundit të vitit tatimor në të cilin thyhet humbja, aplikohet si në vijim:

1.2.1. për ortakëritë ose aranzhimet e ngjashme të bashkimit, së paku 50% e ortakëve duhet të jenë të njëjtit

1.2.2. për entitetet e inkorporuara apo të ngjashme, së paku 50% e aksioneve, së paku 50% e të drejtave të votimit, së paku 50% me të drejtë në dividendë dhe së paku 50% e të drejtave për shpërndarje të kapitalit duhet të mbahen nga personat e njëjtë.

Shembulli 1:

Ortakëria operohet nga tre ortakë (A,B,dhe C), ku secili prej tyre kanë aksione të barabarta në ortakëri. Në vitin 2010 është krijuar humbja tatimore prej 10.000 eurosh.Gjatë vitit 2011 C lëshon ortakërinë dhe zëvendësohet nga ortaku i ri D.Humbja tatimore e vitit 2010 është e mundur që të bartet në vitin 2011 sepse ende është 2/3 e pronësisë së përbashkët (A dhe B).Gjatë vitit 2012 B e lëshon ortakërinë dhe gjithashtu zëvendësohet nga ortaku i ri E. Humbja tatimore e vitit 2010 nuk mund të bartet në vitin 2012 (sepse tani është vetëm 1/3 e pronësisë së përbashkët, A). Q Çdo humbje tatimore që është krijuar në vitin 2011, do të mundet të bartet sepse janë 2/3 e pronësisë së përbashkët ndërmjet vitit 2011 dhe 2012 (A dhe D).

Shembulli 2:

Kompania ka 1000 aksione (ku të gjitha kanë të drejta të barabarta) dhe të cilat janë mbajtur si në vijim:

-Aksionari A 400 aksione

-Aksionari B 300 aksione

-Aksionari C 150 aksione

-Aksionari D 150 aksione

Në vitin pasues zotërimi i aksioneve ka ndryshuar në:

-Aksionari A 300 aksione

-Aksionari B 0 aksione

-Aksionari C 150 aksione

-Aksionari D 0 aksione

-Aksionari E 550 aksione

Humbja tatimore nga viti i parë nuk mund të bartet në vitin pasues sepse ndërmjet tyre Aksionarët A dhe C kanë ruajtur vetëm 450 aksione (më pak se 50% të totalit).

Neni 19

Riorganizimi

1. Paragrafi 3 i nenit 26 të Ligjit parasheh se gjatë riorganizimit shpërndarja e interesit të ekuitetit të tyre për aksionarët, nuk përbën të ardhura të tatueshme të aksionarit. Në rast të riorganizimit të kualifikuar të një NSH, për shpërndarjen e të cilave aplikohet ai paragraf, do të përfshinë aksionet e të ardhurave nga shitja e aksioneve të korporatave vartëse të NSH që është privatizuar për personat në kapacitetin e tyre si bashkë-pronar ose si ko-menagjer të NSH, mirëpo nuk do të përfshijnë pagesat për personat e pushuar nga puna në kapacitetin e tyre si të punësuar ose ish të punësuar të NSH (të cilat do të përbëjnë të ardhura të tatueshme të këtyre personave për qëllim të Ligjit Nr. 03/L-161 Për Tatimin në të Ardhurat Personale).

2. Paragrafi 4 i nenit 26 të Ligjit, parasheh se në rast të riorganizimit të tatimpaguesit që në përgjithësi tatimpaguesit që e marrin biznesin e ndërmarrjes do të jenë të suksesëshëm dhe zën vendin e tatimpaguesve që e dorëzojnë biznesin e ndërmarrjes në lidhje me stoqet, bartjet e humbjeve, llogaritë e dividendave, dhe të gjitha zërat e tjerë të tillë, me përjashtim kur vendoset ndryshe në aktin nën-ligjor të nxjerr nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave. Paragrafet tjera të këtij neni, mbulojnë përjashtimet e tilla.

3. Për qëllime të këtij neni:

3.1. *'Riorganizimi i Skualifikuar'* nënkupton çdo riorganizim për të cilin nuk është marrë miratimi nga Administrata Tatimore e Kosovës. Një riorganizim i tillë i skualifikuar, do të trajtohet si një shitje normale e entitetit apo asetëve të tij;

3.2. *"Ndërmarrja e Re"* nënkupton një korporatë vartëse të një ndërmarrje të themeluar sipas nenit 8 të Ligjit Nr 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

3.3. *"AKP"* nënkupton Agjencinë Kosovare të Privatizimit themeluar në bazë të nenit 1 të Ligjit nr 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

3.4. *"NSH"* nënkupton Ndërmarrjet me Pronësi Publike siq janë definuar në nenin 3 të Ligjit nr. 03/L-067 Për Agjencionin Kosovar të Privatizimit;

3.5. *'Riorganizim i kualifikuar'* nënkupton riorganizimin e një Ndërmarrje Shoqërore (në vijim NSH) të përfshirë në procesin e privatizimit në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AKP-ja, në pajtim me planin e shkruar të riorganizimit për qëllime të biznesit, financiare dhe ekonomike dhe e cila nuk e ka si qëllim të saj shmangien nga tatimi nga çdo palë ose aksionarë. Një riorganizim i kualifikuar aprovohet me shkrim nga ATK;

3.6. *'Riorganizimin'* përfshin si vijon:

3.6.1. një ndryshim në formën e një entiteti, ose në emrin e tij apo vendin e organizimit;

3.6.2. një ri kapitalizim të një entiteti;

3.6.3. një kombinim i dy ose më shumë entiteteve në një, qoftë me shkrirje, përvetësim, ose ndryshe;

3.6.4. një ndarje e një entiteti në dy ose më shumë entitete, qoftë me ndarje, shkëputje, spin off ose ndryshe që (menjëherë pas ndarjes) janë nën kontrollin e entitetit të ndarë, aksionarëve të saj ose të dyja;

3.6.5. marrja e kontrollit të një entiteti në shkëmbim vetëm për interesin e votimit në entitetin e marrë;

3.6.6. marrjen në thelb të të gjitha asetëve të një entiteti në shkëmbim vetëm për interesin e votimit në entitetin e blerë; dhe

3.6.7. transferimin e disa, ose të gjitha asetëve të një NSH te një ose më shumë

Ndërmarrje të Reja në pajtim me Nenin 8 të Ligjit Nr 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

3.7. 'NSH' nënkupton një Ndërmarrje në pronësi shoqërore siç përcaktohet në Nenin 3 të Ligjit nr 03/L-067 Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

4. Në rastin e një riorganizimi të kualifikuar të një NSH, ku NSH themelon një ose më shumë ndërmarrje të reja, pozita tatimore e NSH nuk transferohet në Ndërmarrjet e Reja, por mbetet me NSH-n. Për qëllim të fjalisë së mëparshme, 'pozita tatimore' nënkupton çdo borxh tatimor, çdo humbje tatimore ose ndonjë kredi tatimore për secilën nga tatimet e aplikueshme në Kosovë, por pa cenuar të drejtën e AKP që të caktojë përgjegjësitë për Ndërmarrjet e Reja për shlyerjen e detyrimeve tatimore të tilla ashtu siç mund të miratohet kohë pas kohe midis AKP dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ose si mund të përcaktohet me ligjin e zbatueshëm.

Shembull:

Një NSH, që operon një biznes prodhues ka ndërtesën dhe asetet prodhuese të punishtes. Është punuar me humbje dhe humbjet e saja në tatim në të ardhura që do të barten prej 100,000 euro dhe TVSH-n e pa paguar prej 50,000 euro për dy vitet e fundit. Agjencia Kosovare e Privatizimit, vendos që të privatizoj këtë biznes dhe për këtë qëllim themelohet NeëCo . Një marrëveshje ndërmjet AKP dhe MEF parasheh që borxhet tatimore të pa paguara të 12 muajve të borxhit të TVSH-s (që supozohet të jetë 40,000 prej 50,000 euro të borxhit të TVSH-s në këtë shembull) barten nga NSH në NwCo.

Asetet e NSH do të transferohen në NeëCo (me të njëjtnë vlerë kontabël që e kanë pasur më parë në llogaritë financiare të NSH) e cila do të jetë gjithashtu përgjegjëse për të përmbushur TVSH-n e pa paguar prej 40,000 euro (së bashku me detyrimet tregëtare rrjedhëse) nga NSH. NSH në këtë rast do të mbetet pa asete dhe do të mbetet me obligimin e pa paguar të TVSH-s prej 10,000 euro, dhe me humbje në tatimin në të ardhura prej 100,000, që janë në gjendje të barten mirëpo e mundëshme që mos të shfrytëzohen.

5. Një NSH (ose AKP në emrin e saj) ose një NP e cila është e pranuar, duhet të kërkojë miratim me shkrim nga ATK, se riorganizimi është një riorganizim i kualifikuar. Çdo NSH ose NP që aplikon për një të status të riorganizimit të kualifikuar dorëzonë një kërkesë me shkrim në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenjë, për të sqaruar arsyet pse është duke u bërë riorganizimi, duke paraqitur mekanizmin e riorganizimit dhe duke përmbledhur asetet dhe detyrimet (nëse ka) që do të transferohen. ATK para dhënies së miratimit, e rezervon të drejtën për të kontrolluar librat dhe regjistrimet e NSH-së ose NP-së.

Neni 20 **Transferi i Çmimeve**

1. Paragrafi 4 i nenit 27 i Ligjit, parasheh dallim ndërmjet “vlerës së hapur të tregut” dhe “transferit të çmimeve” që përfshihen në të ardhurat e tatueshme. Kjo dispozitë aplikohet vetëm kur ka transaksione të aseteve ose obligime kontraktuale ndërmjet personave të lidhur. Në kuptim të gjërë, qëllimi i kësaj dispozite është që të sigurojë që çmimet për transaksionet ose obligimet ndërmjet personave të lidhur (transferi i çmimeve) pasqyrojnë çmimet e mbizotërimit të tregut (të përfaqësuara nga vlera e hapur e tregut) – nëse për shembull, mallrat e shitura dhe/ose shpenzimet e përgjithshme të ngarkuara filialit në Kosovë, të tatimpaguesit nga zyra amë e vendosur jashtë Kosovës, janë konsideruar si me qenë në të njëjtin nivel që do të ngarkohet nga pala jo e lidhur që ofron mallra ose shërbime të ngjashme, atëherë nuk do të ketë dallim ndërmjet çmimit të ngarkuar

dhe çmimit të mbizotërimit të tregut, dhe nuk do të lindin të ardhura të tatueshme. Anasjelltas nëse shpenzimet e ngarkuara nga zyra amë janë konsideruar se kanë tejkaluar ato që do të ngarkoheshin nga pala jo e lidhur që ofron mallra ose shërbime të ngjashme (duke i zvogëluar të ardhurat e tatueshme të filialit të Kosovës), diferenca do të shtohet si e ardhur e tatueshme e filialit të Kosovës.

2. Në përcaktimin e çdo difference ndërmjet “vlerës së hapur të tregut” dhe “transferit të çmimeve”, “transferi i çmimeve në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 27 të Ligjit, është çmimi aktual i ngarkuar, ose i ngarkueshëm ndërmjet palëve të lidhura. Përcaktimi i “vlerës së hapur të tregut” prap se prap është më komplekse në metodën që duhet të shfrytëzohet në përcaktimin e saj, që i nënshtrohet shkallës në të cilën janë në dispozicion informatat për palët jo të lidhura që ofrojnë mallra ose shërbime të ngjashme. Metoda që do të shfrytëzohet në përcaktimin e “vlerës së hapur të tregut” është paraqitur në paragrafet si në vijim.

3. Në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 27 të Ligjit, “vlera e hapur e tregut” nëse është e mundur përcaktohet me Metodën e Krahasimit të Çmimeve të pakontrolluara. Kjo metodë mund të shfrytëzohet kur tatimpaguesi blen ose shet mallra të caktuara ose shërbime, me kuantitet të ngjashëm dhe sipas kushteve të ngjashme për palët jo të lidhura në tregjet e ngjashme (një krahasim i brendshëm), ose pala jo e lidhur blen ose shet mallin ose shërbimin e caktuar, me kuantitet të ngjashëm dhe sipas kushteve të ngjashme për palën tjetër jo të lidhur në tregjet e ngjashme (krahasim i jashtëm). Transaksionet mund të shërbejnë si të krahasueshme, edhe përkundër diferencave ndërmjet këtyre transaksioneve dhe transaksioneve të palëve të lidhura ku diferencat mund të maten në baza të arsyeshme dhe mund të bëhen rregullimet e përshtatëshme për të eliminuar efektet e këtyre diferencave. Krahasimet, ose krahasimet e rregulluara ku janë eliminuar diferencat, do të jenë “vlera e hapur e tregut”.

Shembulli 1:

Tatimpaguesi i shet 1,000 tona të produktit prej 80 euro per ton një ndërmarrje të lidhur në grupin e saj të korporatës dhe në të njëjtën kohë shet 500 tona të të njëjtit produkt për 100 euro per ton një ndërmarrje të pavarur. Ky rast kërkon një vlerësim se nëse vëllimet e ndryshme duhet të rezultojnë në rregullimin e transferit të çmimeve. Duhet të hulumtohet tregu relevant duke analizuar transaksionet për produktet e ngjashme për të përcaktuar zbritjet tipike në vëllim.

Shembulli 2:

Një shembull ilustrativ ku mund të kërkohen rregullimet, është kur rrethanat që rrethojnë shitjet e kontrolluara dhe të pa kontrolluara janë identike, me përjashtim të faktit se çmimi i kontrolluar i shitjes është çmimi i furnizimit dhe shitjet e pakontrolluara bëhen nga fabrika duke përjashtuar shpenzimet e transportimit dhe sigurimit. Dallimet në kushtet e transportimit dhe sigurimit në përgjithësi kanë efekt të caktuar, dhe të konstatuara arsyeshëm në çmim. Prandaj, për të përcaktuar çmimet e shitjeve të pa kontrolluara duhet të bëhen rregullime në çmimin për diferencën në kushtet e furnizimit.

4. Kur ka mungesë të krahasimeve ose të dhënave të rregulluara të krahasueshme, ashtu që nuk mund të shfrytëzohet metoda e krahasimeve të çmimeve të pakontrolluara, “vlera e hapur e tregut” do të përcaktohet duke shfrytëzuar metodën e çmimit të rishitjes (e cila është më e përshtatëshme për shfrytëzim nga distributorët) ose metoda e kostos plus (e cila është më e përshtatëshme për shfrytëzim nga prodhuesit) sikur që është paraqitur në paragrafet si në vijim.

5. Metoda e Çmimit të Rishitjes është e shfrytëzueshme kur mallrat ose shërbimet e blera nga tatimpaguesi nga pala e lidhur, janë rishitur për palën jo të lidhur, me veqanti kur tatimpaguesi shitës i shton një vlerë relativisht të vogël mallrave ose shërbimeve. Në këto raste, vlera e hapur e tregut llogaritet duke zbritur nga çmimi i rishitjes një marzhë të përshtatëshme të rishitjes bruto e

cila mundëson që shitësi ti mbulojë shpenzimet operative të tij dhe të fitoj një fitim sipas mbizotërimit të tregut të bazuar në funksionet e kryera, asetet e shfrytëzuara dhe rreziku i supozuar. Kjo marzhë bruto mund të përcaktohet duke ju referuar marzhës së çmimit të rishitjes të fituar nga anëtarë i të njëjtës grup si tatimpagues në krahasimet e transaksioneve të pa kontrollura (krahasimet interne) ose marzha e çmimit të rishitjes e fituar nga palët jo të lidhura në transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara (krahasimet eksterne).

Shembulli 1:

Supozoni se janë dy distributor, që shesin të njëjtin produkt në të njëjtin treg, me të njëjtin emër të markës. Distributori A ofron garancion; Distributori B nuk ofron asgjë. Distributori A e përfshinë garancionin si pjesë të strategjisë së tij të çmimvënjes, dhe kështu i shet produktet e saja me çmim më të lartë që rezulton në një marzhë më të madhe të fitimit bruto (nëse shpenzimet e shërbimit të garancionit nuk janë marrë parasysh) se sa ajo e Distributorit B, i cili shet me çmim më të ulët. Dy marzhat nuk janë të krahasueshme deri sa të bëhet një rregullim për të marrë parasysh dallimin.

Shembulli 2:

Kompania shet produktin, nëpërmes të distributorëve të pavarur në pesë shtete në të cilat nuk ka vartës. Distributorët, thjesht i shesin produktet dhe nuk kryejn ndonjë punë shtesë. Në një shtet, kompania vendos një vartës. Meqë tregu i caktuar ka një rëndësi strategjike, kompania kërkon nga vartësi që të shes vetëm produktin e tij. dhe të kryej aplikimin teknik për klientët. Edhe nëse faktet dhe rrethanat tjera janë të ngjashme, nëse marzhat vijn nga ndërmarrjet e pavarura që nuk kanë rregullim ekzskluziv të shitjes, ose kryejnë aplikime teknike sikurse këto të ndërmarrja nga vartësi, është e nevojshme që të shyrtohet se nëse duhet të bëhet ndonjë rregullim për të arritur krahasueshmërinë.

6. Metoda e Kostos Plus është e shfrytëzueshme, kur nga tatimpaguesi krijohen shpenzimet në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve për palën e lidhur. Në këto raste vlera e hapur e tregut përcaktohet, duke ju shtuar shpenzimeve të krijuara nga tatimpaguesi (llogaritur në pajtueshmëri me principet e kontabilitetit që janë në përgjithësi të pranueshme për një industri të caktuar) marzhat bruto të krahasueshme të cilat përcaktohen duke ju referuar marzhës kost plus të fituar nga anëtarë i të njëjtit grup, si tatimpagues në transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara (krahasime të brendshme), ose marzha e kostos plus e fituar nga palët jo të lidhura në krahasimin e transaksioneve të pakontrolluara (krahasimet e jashtme). Në cilindo rast, deklaratat e shfrytëzuara për të përcaktuar një marzh të mbizotërimit të tregut, duhet të jenë ato të fituara nga personat që kryejnë funksione të ngjashme dhe më e preferueshme që shesin mallra të ngjashme për palët jo të lidhura. Kur transaksionet nuk janë të krahasueshme në asnjë mënyrë, dhe diferencat kanë një efekt të dukshëm në çmim, tatimpaguesit duhet të bëjnë rregullime, për të eliminuar efektin e diferencave të tilla (si diferencat në eficiencën relative të furnizuesit, dhe çdo përparësi që krijon aktiviteti për grupin që përfshin tatimpaguesin).

Shembulli 1:

A është prodhues vendor i mekanizmave të minutazhit për orët e tregut masiv. A i shet këto produkte vartësit të saj të huaj B. A, fiton 5 per qind të marzhës së fitimit bruto për operimet e saja prodhuese. X, Y, dhe Z janë prodhues jo të lidhur vendor të mekanizimit të minutazhit për orët e tregut masiv. X, Y, dhe Z i shet blerësve të huaj jo të lidhur. X, Y, dhe Z fiton marzhën e fitimit

bruto për operimet e saja prodhuese që rangohen prej 3 deri në 5 per qind. A, llogaritë shpenzimet e mbikqyrjes, të përgjithëshme dhe administrative si shpenzime operative dhe prandaj këto shpenzime nuk pasqyrohen në koston e mallrave të shitura. Marzhat e fitimeve bruto të X, Y, dhe Z, megjithatë pasqyrojnë shpenzimet e mbikqyrjes, të përgjithëshme dhe administrative si pjesë e mallrave të shitura. Prandaj marzhat e fitimit bruto të X, Y, dhe Z duhet të rregullohen për të siguruar përputhshmëri me kontabilitetin.

Shembulli 2:

Kompania C në shtetin D është 100% vartëse e kompanisë E, e vendosur në shtetin F. Në karahasim me shtetin F, pagat janë shumë të ulëta në shtetin D. Në shpenzimet dhe rrezikun e kompanisë E, pakot e televizionit janë montuar nga kompania C. Të gjitha komponentet e nevojshme, njohuritë specifike, etj. sigurohen nga kompania E. Blerja e produktit të montuar, është i garantuar nga kompania E, në rastë se pjesët e televizionit dështojnë në përmbushjen e standardeve të caktuara të kualitetit. Pas kontrollimit të kualitetit, pjesët e televizionit sjellen – në shpenzim dhe në rrezikun e kompanisë E – në qendrat e distribuimit që kompania E i ka në disa shtete. Funkzioni i kompanisë C, mund të përshkruhet thejstë si kosto e funksionit të prodhimit. Rreziku i kompanisë C mund të bartë diferencat eventuale për kualitetin, dhe kumatitetin e miratuar. Bazat për aplikimin e metodës së koston plus do të formohen nga të gjitha shpenzimet e lidhura me aktivitetet e montimit.

Shembulli 3:

Kompania A e grupit të korporatës, pajtohet me kompaninë B të njëjtit grup për të zhvilluar hulumtimin e kontratës për kompaninë B. Të gjitha rreziqet e dështimit të hulumtimit barten nga kompania B. Kjo kompani gjithashtu zotëron të gjitha të paprekshmet, të zhvilluara nëpërmes të hulumtimit dhe prandaj ka gjasa të fitimit që rezultojnë nga hulumtimi. Ky është një organizim tipik për aplikimin e metodës së koston plus. Të gjitha shpenzimet për hulumtim, me të cilat jaë pajtuar të gjitha palët e lidhura, duhet të kompenzohen. Kostoja plus shtesë mund të pasqyrojë se sa është inovativ dhe kompleks hulumtimi i zhvilluar.

7. Kur tatimpaguesi beson që metodat e mësipërme nuk mund të shfrytëzohen, dhe mund të sigurojë evidencë për këtë, Administrata Tatimore e Kosovës mund të lejojë shfrytëzimin e metodës së shpërndarjes së fitimit. Metoda e shpërndarjes së fitimit mund të zbatohet kur operimet e dy ose më shumë palëve të lidhura janë shumë të integruara, duke e bërë të vështirë për të vlerësuar transaskionet e tyre në baza individuale dhe/ose aty ku ekzistenca e të paprekshmeve të qmueshme dhe unike e bën të pamundur krijimin e nivelit të duhur të krahasimit me transaskionet e pa kontrolluara sipas një metode tjetër.

7.1. Hapi i parë sipas kësaj metode është që të përcaktohet fitimi total i fituar nga palët nga transaskionet e kontrolluara. Metoda e shpërndarjes së fitimit alokon fitimin total të integruar të lidhur me transaskionet e kontrolluara, e jo fitimin total të grupit si tërësi. Fitimi që do të shpërndahet është fitimi operativ para zbritjes së interesit dhe tatimit.

7.2. Hapi i dytë është që të shpërndahet fitimi ndërmjet palëve, bazuar në vlerën relative të kontributeve të tyre të transaskioneve të palëve të lidhura, duke marrë parasysh funksionet e kryera, asetet e shfrytëzuara, dhe rreziqet e supozuara nga secila palë e lidhur, lidhur me atë se cilat palë të lidhura do të kishin pranuar, me rezultat i cili është vlera e hapur e tregut.

8. Në rast se asnjëra nga metodat e mëparshme nuk mund të përdoret, ATK mund të lejojë shfrytëzimin e metodës së marzhës neto të transaskioneve. Kjo metodë krahason marzhën e fitimit neto të tatimpaguesit që del nga transaskionet e palëve të lidhura, me marzhat e fitimit neto të realizuara nga palët jo të lidhura nga transaskionet e ngjashme, dhe shikon marzhën e fitimit neto që lidhet me një bazë të përshtatëshme si shpenzimet, shitjet ose asetet, duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit të biznesit, me rezultatin i cili është vlera e hapur e tregut.

9. Tatimpaguesit të cilët zhvillojnë transaskione me palët e lidhura duhet të mbajnë dokumentacion të mjaftueshëm, për të arsyetuar zgjedhjen e tyre të metodës së përcaktimit të vlerës së hapur të tregut, dhe të tregojnë se kjo e prodhon rezultatin e mbizotërimit të tregut.

Neni 21 **Të Ardhurat Komerciale të OJQ-ve**

1. Paragrafi 1 i Nenit 33 të Ligjit ka të bëjë me të ardhurat komerciale të OJQ-ve . Shprehja *“Aktiviteti komercial apo tjetër që nuk është ekskluzivisht i lidhur me qëllimin e saj publik”* përfshinë këto kuptime:

1.1. në rastin e një kishe që shet qirinj dhe i shfrytëzon të ardhurat nga shitja për përmirësimin e objekteve për të shërbyer më mirë komunitetin, një aktivitet i tillë komerciale do të gjykohej të jetë ekskluzivisht i lidhur me qëllimin e përfitimit publik.

1.2. në rastin e një OJQ që veprojnë në promovimin e veprimtarive bujqësore, shitja e farërave dhe fidanëve, do të konsiderohet të jetë ekskluzivisht e lidhur me veprimtarinë e saj primare të përfitimit me kusht që OJQ-ja të përdor të ardhurat e shitjes brenda fushëveprimit të qëllimit të përfitimit publik.

1.3. në rastin e një OJQ-je që vepronë në fushën e shëndetësisë, e cila drejton një kiosk të shitjes me pakicë, aktiviteti i tillë komerciale nuk do të konsiderohet si ekskluzivisht i lidhur me qëllimin primar të saj për përfitim publikun . Në këtë rast të ardhurat që rrjedhin nga kioski me shitje me pakicë do të nënshtrohen tatimit në të ardhurat në korporata, të reduktuara nga çdo zbritje që lidhet direct me kioskin me shitje me pakicë të cilat lejohen me Ligj.

2. Paragrafi 2 i nenit 33 i Ligjit i jep të drejtën ATK-së ta trajtoj “tepricën e fitimit” të krijuar nga OJQ-të si të nënshtuar tatimit në të ardhurat në korporata. OJQ-ja me status të përfitimit publik mbështetet nga donatorët të cilët pranojnë zbritje nga të ardhurat e tyre bruto në mënyrë që të inkurajojnë kontributet private drejt plotësimit të nevojave sociale të shoqërisë. Sipas rrethanave të tilla, një OJQ do të pritet që të operojë me një marzhë më të ulët se sa biznesi privat që ofron shërbime të njëjta apo të ngjashme. Në të vërtetë, neni 17.2 I Ligjit nr.03/L -134 Për Lirinë e Asociimit të Organiatave Jo Qeveritare, parasheh që OJQ-të do të marrin statusin e përfitimit publik vetëm në rast se përfitime të konsiderueshme ofrohen falas ose me lire se sa vlera e drejtë e tregut, për grupe ose individ në kushte të pavolitshme. Në të njëjtën kohë është e njohur se OJQ-të me status të përfitimit publik kanë të drejtën të krijojnë aq fitim i cili është i nevojshëm për vetë mbajtje dhe mundësisht të siguroj zhvillimin dhe zgjerimin e shërbimeve. Për aq sa këto fitime të OJQ-ve i tejkalojnë ato të nevojshmet për këtë qëllim, ato do të konsiderohen si “teprica e fitimit”.

3. Në mënyrë më specifike në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 33 të Ligjit, situatat si në vijim mund të trajtohen se e krijojnë “tepricën e fitimit”:

3.1. kur fitimet që dalin nga aktivitetet e OJQ-s lidhur me qëllimin e saj për publik, zvogëlohen nga pagesat për menagjerët e OJQ-s, zyrtarët, të punësuarit ose anëtarët të shumave të cilat janë dukshëm më të mëdha nga ato që zakonisht do të paguheshin këtyre personave duke pasur parasysh përgjegjësitë e tyre dhe detyrat që i kanë kryer lidhur me këto aktivitete;

3.2. në rastë të OJQ-s e cila siguron mallra dhe shërbime, ku fitimet e krijuara nga aktivitetet e OJQ-së lidhur me qëllimin e saj publik janë bërë duke ngarkuar çmime të cilat janë shumë nga ato që zakonisht do të ngarkoheshin duke pasur parasysh sasinë dhe kualitetin e mallrave dhe shërbimeve dhe kushtet në të cilat janë siguruar;

3.3. në rastë të OJQ-ve të cilat japin me qira prona, ku fitimet e krijuara nga aktivitetet e OJQ-s lidhur me qëllimin e saj publik janë bërë duke ngarkuar qira me norma shumë më të larta se ato që zakonisht do të paguheshin duke pasur parasysh standardin dhe lokacionin e pronës dhe kushtet tjera të marrëveshjes së qirasë;

3.4. në rastë të OJQ-ve të cilat huazojnë para, si institucionet mikrofinanciare, kur fitimet e krijuara nga aktivitetet e OJQ-s lidhur me qëllimin e tyre publik janë bërë duke ngarkuar interes me norma të cilat janë dukshëm më të mëdha nga ato që do të paguheshin zakonisht duke pasur parasysh rrezikun, afatin dhe kushtet tjera të kredive;

3.5. në secilin rast “teprica e fitimit” që do të i nështrohej tatimit në të ardhura në korporata është shuma e fitimit të tepërt të bërë si më lartë në krahasim me atë që zakonisht do të bëhej (në vendë të shumës së plotë të fitimit).

4. Për qëllim të përcaktimit të shkallës në të cilën çdo “tepricë e fitimit” e fituar nga një OJQ- sipas paragrafit 2 të këtij neni, ATK duhet të jetë në gjendje të merr informata lidhur me atë OJQ nga:

4.1. kontrolli i OJQ-s (siq është autorizuar me paragrafin 2 të nenit 33 të Ligjit);

4.2. raportet vjetore të OJQ-s që i deklarojnë sipas nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-134 mbi Lirinë e Asociimit në Organizatat jo Qeveritare në organin kompetent sipas atij Ligji;

4.3. ndonjë pale të tretë ose burime tjera ku ATK ka qasje në informata sipas ligjit.

Neni 22 Deklaratat Tatimore

1. Në pajtim me paragrafin 1 të nenit 34 të Ligjit mbi Tatimin në të ardhurat e korporatave, deklaratat tatimore dhe pasqyrat financiare duhet të dorëzohen në ATK me apo para ditës së 31 marsit të vitit që pason periudhën tatimore. Këto deklarata / pasqyra financiare mund të dorëzohen në ATK nëpërmjet një banke të autorizuar ose institucioni financiar. Deklarata tatimore do të konsiderohet si një vlerësim i bërë nga vetë tatimpaguesit.

2. Kur data e afatit të dorëzimit të çdo deklarate tatimore ose pasqyrë informacioni, është e shtunë, e diel apo Festë shtetërore, këta formularë mund të dorëzohen, pa ndëshkim për deklarim me vonesë, më së voni në ditën e parë të punës pas së shtunës, së dielës apo Festës Shtetërore.

3. Për qëllime të tatimit në të ardhura, ortakëritë janë të detyruara të deklarojnë deklarata tatimore vjetore për ortakëri, për të ardhura dhe shpenzime (këta nuk janë të detyruar të deklarojnë deklarata për tatim në të ardhurat e korporatave) të cilat tregojnë për pjesën e fitimeve apo humbjeve të ortakërive që i janë alokuar ortakëve, por nuk janë të detyruar që të bëjnë ndonjë pagesë të detyrimit tatimor përkatës. Vetë ortakët duhet të llogarisin për pagesën e tatimit në lidhje me të gjitha të ardhura që ata marrin nga ortakëria. Ortakët e inkorporuar të ortakërive të cilët janë të detyruar të deklarojnë deklarata për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe të cilët marrin aksione fitimi nga ortakëria, duhet ti përfshijnë ato me të ardhura e tjera që i nështrohen tatimit në të ardhurat e korporatave.

Neni 23

Librat dhe Regjistrat

1. Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej 50,000 euro ose më tepër dhe ata me të ardhura vjetore bruto më të ulëta se 50,000 euro të cilët zgjedhin të taten mbi baza të të ardhurave reale, do të mbajnë librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e:

1.1. Neni 36 të Ligjit; dhe

1.2. Paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për Zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

2. Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto më të ulëta se 50,000 euro të cilët nuk kanë zgjedhur të taten në bazë të të ardhurave reale, do të mbajnë librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e :

2.1. Neni 37 të Ligjit; dhe

2.2. Paragrafit 2 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 Për Zbatimin e Ligjit Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

3. Tatimpaguesit e përmendur në paragrafet 1 dhe 2 janë të obliguar që të lëshojnë fatura/kuponë për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të bëra nga ata.

4. Përmbajtja e librave dhe regjistrimeve të referuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dhe i faturave / kuponëve të referuar në paragrafin 3 të këtij Neni, duhet të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 15/2010 Për Zbatimin e Ligjit Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

5. Dispozitat e mëposhtme të Ligjit nr 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, zbatohen në lidhje me librat dhe regjistrimet e referuara në këtë nen:

5.1. Neni 13, në lidhje me përkthimin, mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave dhe periudhat të cilave duhet të ju përkasin regjistrimet;

5.2. Neni 14, në lidhje me qasjen në regjistrime nga ATK, dhe për heqjen dhe kopjimin e të dhënave të tilla;

5.3. Neni 14 dhe 15, në lidhje me kërkesën e tatimpaguesit për të prodhuar të dhënat kur kërkohet nga ATK;


5.4. Neni 19, në lidhje me të dhënat që janë humbur ose shkatërruar;

5.5. Neni 15 dhe 53, në lidhje me ndëshkimet për mos mbajtjen e regjistrimeve ose për mos lejimin e qasjes së ATK-s në regjistrime.

Neni 24

Hyrja Në Fuqi

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi me nënshkrimin nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Ahmet SHALA


Ministër i Ekonomisë dhe Financave

Datë 19 / 11 / 2010